- Ligji Nr.9587, date 20.07.2006 “Per mbrojtjen e biodiversitetit”.
- Ligji Nr. 8766, date 05.04.2001, “Te mbrojtjes ndaj zjarrit”.
- Ligji Nr. 9108, date 17.07.2003, “ Per substancat dhe preparatet kimike”.
- Ligji Nr.7819, date 27.04.1994, ”Per pronesine industriale”.
- Ligji Nr.9290, date 07.10.2004, ”Per produktet e ndertimit”.

- V.K.M. Nr.103, date 31.03.2002, ”Per monitorimin e mjedisit ne Republiken e Shqiperise”.
- V.K.M. Nr. 435, date 12.09.2002, “Per normat e shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise”.
- V.K.M. Nr. 249, date 24.04.2003, “Per dokumentacionin per Leje Mjedisore dhe te elementeve te Lejes Mjedisore”.
- VKM Nr. 268, date 24.04.2003,“Per certifikimin e specialisteve, per R.V.N.M.. dhe auditimin mjedisor”.
- V.K.M. Nr.805, date 04.12.2003, “Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis, per te cilat kerkohet leje mjedisore”.
- V.K.M. Nr. 177, date 31.05.2005, “Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengta dhe kriteret e zonimit te mjediseseve ujore pritesë”.
- Udhezimi Nr.1, date 07.01.2008, i Ministrit te Mjedisit, ”Per dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar Leje Mjedisore”.
- Udhezimi Nr.429, date 17.11.2009, i Ministrit te Mjedisit, “Per rregullat dhe procedurat per paisjen me leje mjedisi ne kuader te Qendres Kombetare te Licensimit”.
- Udhezimi Nr.6, date 27.12.2006, “Per miratimin e metodologjise se vleresimit te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie”.

- V.K.M.Nr.587, date 07.07.2010, "Per monitorimin dhe kontrollin e nivelit te zhurmave ne qendrat urbane dhe turistike".
- Udhezimin Nr.8, date 27.11.2007, "Per nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara.
- Udhezimi Nr.3, date 02.12.2013, i Ministrit te Mjedisit, "Per dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar Leje Mjedisore".

Procedura e pergatjes se Raportit te R.V.N.M. ne vleresim.

Ne V.K.M. Nr. 805, date 04.12.2003 Per "Miratimin e Listes se Veprimtarive, qe Ndikojne ne Mjedis, per te cilat kerkojne Leje Mjedisore", si dhe ne Ligjin Nr.10 440, datë 07.07. 2011, "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" gjendet e listuar dhe veprimtaria per vleresim. Per kete arsye, ne zbatim te V.K.M. Nr.249, date 24.04.2003 "Per Miratimin e Dokumentacionit per Leje Mjedisore dhe te Elementeve te Lejes Mjedisore", ne Aneksin 1, ne piken 4 parashikohet dhe raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis, i cili do te hartohet sipas procedurave te parashikuara ne Ligjin Nr.10 440, datë 07.07. 2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis", dhe udhezimeve te dala ne zbatim te tij, Vleresojme se kjo veprimtari do te pajiset me Leje Mjedisore dhe do te nenshtrohet vleresimit te ndikimit ne mjedis i permblendhur te pergatitjes se raportit te VNM sepse nuk ka asnje kontakt ne zona te mbrojtura apo nderkufitare. Kjo pike gjen zbatim ne Kreun II, "Programi Kombetar i Monitorimit te Mjedisit" ku ne piken 5 shprehet: "Personat fizik dhe juridik vendas dhe te huaj, veprimtaria e te cileve pajiset me leje mjedisore, te zbatojne programe monitorimi te treguesve mjedisor te trysnise per burime individuale te levizshme dhe te palevizshme, si dhe te dokumentojne te dhenat perkatese sipas modeleve te miratuara nga MMPAU" B "Shkembimi i te dhenave":

1. Personat, fizikë dhe juridikë, që janë subjekte të lejes mjedisore, të dërgojnë në agjencitë rajonale të mjedisit (ARM), të dhënat e monitorimit të paktën 4 herë në vit, si edhe t'i vënë në dispozicion të inspektorëve të mjedisit, gjatë inspektimit të ushtruar prej tyre. Treguesit e monitoruar nga institucionet e Akademisë së Shkencave dhe Instituti i Shëndetit Publik përjashtohen nga detyrimi për të dërguar në ARM të dhënat e monitorimit.

Analiza e alternativave.

Diskutimi dhe analizimi i alternativave ne Raportin e V.N.M. duhet te merren ne konsiderat masa te tjera te aplikueshme, te cilat mund te ndikojne ne eliminimin e efekteve negative te identifikuar ne mjedis. Ky seksion ne baze te ligjit ne fuqi "Per Vleresim te Ndikimit ne Mjedis, shprehet qarte se projekti ben pjese ne shtojcen e II dhe si e tille do ti nenshtrohet **procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis (neni 7 pika 2/a, Ligji Nr.10 440, datë 07.07. 2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis")**

Alternativat e meposhtme u vleresuan dhe u diskutuan si kuptim i minimizimit te efekteve ne mjedis. Me poshte jepen tre alternativat ne shqyrtim:

1. "Jo-Veprimi"
2. Projekti i paraqitur ne kete raport.
3. Projekti paraqitur ne kete raport me vendndodhje ne zone me status te zakonshem.

"Jo-Veprimi" Kjo alternative eshte e kerkuar per te vleresuar mjedisin natyror, ne gjendjen e tanishme, pa implementim te ketij projekti. Kjo pike eshte e nevojshme per nxjerrje perfundimi duke i marre ne konsiderate te gjitha mundesite e zhvillimit te kesaj alternative, ku do te kete nje efekt te paperfillshem ne mjedisin fizik. Alternativa per projektin e propozuar, e Jo Veprimit, e cila identifikohet dhe do te vleresohet si pike referimi per te realizuar ndikimet e mundshme ne mjedis. Kjo alternative minimizon efektin dhe identifikon floren dhe faunen si dhe ndikim ne zonat te pasura me bimesi.

Perfundime te analizës se alternatives.

Mbeshtetur sa me siper, alternativa e dyte eshte efiçiente per kete projekt. Ndikimi i ketij projekti ne mjedis sjell disa efekte te lokalizuara negative ne mjedisin e zones perreth, por ndikimi i tyre do te jepet me i detajuar ne seksionin e vleresimit te ndikimit ne mjedis te projektit ne vleresim. Duke patur parasyshe gjithmon se aktivitetet jetesore te njerezimit kerkojne çdo dite sigurimin e komoditeteve te sherbimeve dhe cilesi sa me te larte te artikujve te sherbimeve, një rendesi të vecantë ze dhe prodhimi i mineraleve nga konçesjonet ne kete fushe.

Ne materialin qe do te paraqisim do te trajtojme ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit te shfrytezimit mineral te objektit argjiles ne zonen minerare Nr.346/6, objekti "Gryka e Zeze", njesia vendore Kolsh, rrethi Lezhe.

1.3 Pershkrim te metodikes te zbatuar per hartimin e raportit te VNM –se

1.3.1 Autoret e hartimit te raportit te thelluar te VNM-se

Autoret e hartimit te Raportit te vleresimit te ndikimit ne mjedis jane: Ing. pasurimi Zef Pistja, Inxh. Miniere Hekuran Muça, me pervojete gjate pune disa vjeçare pothuajse në të gjitha fushat e mjedisit dhe gjeologo-minerare.

1.3.2 Metodika e zbatuar dhe menyra e sigurimit te informacionit per hartimin e raportit te VNM-se.

Per sa i perket metodikes se pershkrimit eshte provoje rreth 12 vjeçare duke ndjekur te gjithë treguesit pozitive dhe negative ne zbatimin ne çdo nyje te projektit qe ne rastin tone eshte shfrytezimi i mineralit te argjiles. Per sa i perket informacionit ai eshte grumbulluar si rezultat i vrojtimit ne karriere te operacioneve, por dhe nga shfrytezimi i te dhenave nga literatures.

1.3.3 Konsultimet e realizuara gjate hartimit te raportit te thelluar te VNM-se

Per sa i perket konsultimeve per hartimin e raportit te VNM-se nga ana jone u perqendrua:

Konsultimet me publikun e gjere sidomos te fshatrave per rreth vendit te funksionimit te projektit.

Konsultimin me organet e qeverisjes vendore qe mbullojne teritorin e funksionimit te karrieres "argjiles".

Konsultimin me perfaqesues te ARM rajonale.

Konsultim me organizat jo qeveritare qe veprojne permjedisin ne rajon.

Te gjitha keto diskutime u muaren parasyshe ne hartimin e RVNM per karrieren e argjiles objektit "Gryka e Zeze", Lezhe.

1.3.4 Nje pershkrim te veshtiresive qe zhvilluesi ka hasur gjate hartimit te informacionit te kerkuar.

Veshtiresi te informacioneve nuk ka pasur ne kete faze qe ne jemi sot ne studim te ketij projekti , sepse kemi çdo veprim per shfrytezim ne skice te pa zbatuar dhese e tille ne nuk e monitorojme direkt çdo receptor qe ndikon ne mjedis shfrytezimi i mineralit te argjiles në karriere. Me fillimin e punimeve te zbatimit atehere do te duken veshtiresite.

2 Pershkrimi i projektit.

2.1 *Pershkrimi i qellimit te projektit.*

Projekti ishfrýtezimit ka si qellim shfrýtezimin e mineralit te argjilës si lende e pare per prodhimin e tullave dhe tjegullave. Ky projekt eshte zgjedhur ne menyre te atille qe te kete shfrýtezim maksimal te argjiles, ne sipërfaqen e zones ku do te ndertohet karriera. Shfrýtezimi do te konsistoje ne pastrimin e mbuleses dhe nxjerrjen e mineralit te argjiles, me ane te forces mekanike e koves se ekskavatorit ose te fadromes.




Foto nga objekti " Gruke e Zeze" Lezhe

RAPORT I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

2.2 Planimetria e vendosjes se projektit , ku pasqyrohet:

HARTA TOPOGRAFIKE ME KONTURIN E KERKUAR PER LEJE SHFRYTEZIMI
SHKALLA 1 : 10 000



Nr. i pikes	KOORDINATAT		Nr. i pikes	KOORDINATAT	
	Y	X		Y	X
1	43 87 480	46 30 305	5	43 87 800	46 29 505
2	43 88 000	46 30 035	6	43 87 260	46 29 695
3	43 88 080	46 29 555	7	43 87 180	46 29 865
4	43 87 900	46 29 555	8	43 87 320	46 30 225

S = 0.48Km²

SHOQERIA :
"MILIS" Sh.p.k. LEZHE

STUDIMI TEKNIKO EKONOMIK
DHE PROJEKTI I SHFRYTEZIMIT
(Shtyrie afati)

2.2.1 Kufijte e sipërfaqes se kerkuar.

Pika	Y	X
1	43 87 480	46 30 305
2	43 88 000	46 30 035
3	43 88 080	46 29 555
4	43 87 900	46 29 555
5	43 87 800	46 29 505
6	43 87 260	46 29 695
7	43 87 180	46 29 865
8	43 87 320	46 30 225

2.2.2 Te dhena mbi sipërfaqen e tokes qe do te perdoret nga projekti ne ndertim dhe funksjonimi i tij.

Sipërfaqja e tokes qe do te perdoret ne shfrytezim e argjiles eshte me e vogel se sa ne lejen e shfrytezim. Kjo toke qe eshte perdorur dhe qe perdoret eshte toke inproduktive ku ne nje pjese te mire te saj mungon fare se eshte errodur nga sipërfaqja e shkembinjëve. Nje pjese e zones eshte shfrytezuar gjate periudhes 30 vjeçare..

2.3 Skicat dhe planimetritë e objekteve te projektit dhe strukturavete projektit

2.4 Peshkrimi i proceseve ndertimore dhe teknologjike.

2.4.1 Kapacitetet prodhuse /perpunuese.

Kapaciteti minimal i prodhimit do te jete 10 000m³/vit dhe kapaciteti maksimal do te jete deri 12000 m³/vit.

2.4.2 Sasite e lendeve te para

Lenda e pare per prodhimin e tullave dhe tjegullave eshte vet minerali dhe Lenda djegese (karburanti).

2.4.3 Produktet perfundimtare te projektit qe do te zhvillohet.

Produkti perfundimtare nga perpunimi i mineralit te argjiles janetullat dhe tjegullat qe prodhohen ne fabrike.

2.5 Infrastruktura e nevojshme per zbatimin e projektit.

2.5.1 Lidhja me rrjetin elektrik.

Nuk ka lidhje.

2.5.2 Furnizimi me uje.

Furnizimi do te behet me ujine nepermjet botit te vendosur ne kamion.

2.5.3 Shkarkimin e ujrave te ndotur.

Shkarkimi i ujrave te ndotur (nuk ka).

2.5.4 Shkarkimi i mbetjeve.

Shkarkimi imbetjeve do te behet ne shkallet e karrieres dhe ne sheshin e depozitimit te karrieres.

2.5.5 Informacion per rruget egzistuese dhe nevojen e hapjes se rrugeve te reja.

Egziston rruga deri ne objekt.

2.6 Programi per ndertimin.

2.6.1 Kohezgjatja e ndertimit.

Punimet e ndertimit te rrugeve te jashteme dhe te brendeshme te karrieres 12muaj.

2.6.2 Kohezgjatja e planifikuar per funksjonimin eprojektit.

Me ligjin e koncesjoneve minerare jepet leja e shfrytezimit me koncesion per nje periudhe **25-35 vjeçare**.

2.6.3 Faza e planifikuara per rehabilitimin e siperfaqes pas mbarimit te projektit.

Mbas mbarimit te ndertimit rrugeve dhe shfrytezimit te argjiles shoqeria eshte ne aktivitet te vazhdueshem per rehabilitimin e mjedisit te teritorit ku jane kryer punimet minerare te shfrytezimit. Rehabilitimi do te kryhet hap pas hapi mbasi shfrytezimi eshte parashikuar nga larte poshte. Menjehere me krijimin e hapsirave te lira nga kryerja e veprimtarise minerare te shfrytezimit do te kryhet rehabilitimi i mjedisit.Rehabilitimi do te kryhet duke mbushur zonen e shfrytezuar deri tek kuota e e larte +2.5 me nivelit te fundit te shfrytezimit.

2.7 Menyrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve te projektit.

Menyrat dhe metodat per ndertimin e karrieres janë te percaktuara qarte ne projektin e shfrytezimit. Fillimisht do te ndertohen rruget lidhese te shkalleve duke ndertuar dy transhe dhe duke u ulur deri ne nivelin e fundit karrieres.

2.8 Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre (materjale ndertimi, uji dhe energji).

Lende e pare eshte vetem karburanti per makinerite e renda i cili do te sigurohen ne tregun e licensuar

2.9 Informacion per lidhjet e mundeshme te projektit me projektet e tjera prane projektit tone.

Sot per sot do te funksionojne lidhja e karrieresme rruge automobilistike nga rruga nacionale deri ne karriere.

2.10 Informacion lidhur me alternativat e marra ne konsiderate per sa i takon perzgjedhjes se vendndodhjes se projektit dhe teknologjise qe do te perdoret.

Per sa i perket zgjedhjes se projektit ka favore mbasi shoqeria ka nje eksperience te gjate ne shfrytezimin e mineralit te argjiles.

2.11 *Perdorimi i lendeve te para gjate funksionimit si: Sasia e ujet te nevojshem , energjine, lenda djegese dhe menyren e sigurimit te tyre.*

Per perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit te projektit eshte karburanti qe do te blihet nga pika me e afert dhe do te magazinohet prane karrieres.

2.12 *Aktivitetet tjera qe mund ti nevojiten per zbatimin e projektit , si ndertimi i kampeve dhe rezidencave.*

Ne objekt eziston gjithë infrastruktura e nevojshme.

2.13 *Informacionet per lejat dhe licensat e nevojshme per projektin e kerkuar, nga legjislacionet ne fuqi si dhe institucionet ne fuqi si dhe institucionet kompetente per lejimin , licencimin e projektit.*

Dhenia e lejes minerare te shfrytezimit nga Ministria e Energjise dhe Industrise.
Dhenia e lejes mjedisore per shfrytezimin e argjiles nga Ministria e Mjedisit

3 *Nje pershkrim i analizes se zbatimit te projektit dhe elementeve te vecante te tij, si dhe arsye per alternativen e zgjedhur duke marre parasysh ndikimet ne mjedis te seiciles alternative.*

Projekti qe do te zbatohet eshte zgjedhur qe te kete nje ndikim sa me te vogel ne mjedisin per rreth tij. Po ti marrim veprat nje e nga nje :

- Rruga hyrese nga rruga automobilistike egzistuese per ne karrieren e re.
- Rruget e brendeshme te karrieres.
- Ndertimi i shkalleve te karrierees na pika me e larte ne piken me te ulet.

4 *Nje pershkrim i gjendjes dhe i vlerave egzistuese te mjedisit qe mund te ndikohen nga zbatimi i projektit te propozuar.*

4.1 *Pershkrimi i karakteristikave fizike te zones se projektit.*

4.1.1 *Pershkrimi i faktoreve klimaterik.*

Objekti i kerkuar ben pjese ne Zonen qendrore te zones klimatike mesdhetare.

Klima

Zona e Lezhes ben pjese ne zonen me klime mesdhetare me dimer te bute e vere te nxehte, me reshje minimale ne muajt Qershor, Korrik dhe Gusht dhe maksimale ne muajt Shkurt, Mars, Prill, Maj, Shtator dhe Dhjetor.

Perdorimi i makinerive te shpimit, zbarkimit, ngarkimit dhe transportit te tipit per karriera do te beje te mundur kapjen dhe parandalimin e gazeve, qe emetohen nga motorat me djegie te brendeshme.

Pershkrimi gjeomorfologjik dhe i sizmicitetit te zones.

Zona e kerkuar ben pjese ne zonen e tektoniko-faciale te Kraste-Cukalit e cila perfshin rajonin e Cukalit dhe brezin midis zones se Mirdites ne Lindje dhe asaj te Krujes ne Perendim. Ne kete zone takohen depozitimet palezoike mesozoike dhe me pak Paleogene, por per rastin ne fjale rendesi paraqesim sepozitimet kuaternare te cilat po I trajtojme me poshte:

Depozitimet kuaternare jane ndare vetem nga pikepamja morfologjike duke dalluar vec depozitimeve pliocenike kuaternare dhe depozitimeve aluviale, proluviale, koluviale, deluviale, akullnajore, kenetore, liqenore e detare.

Depozitimet kryesore jane:

Depozitimet e pliocenit te siperm-kuaternarit te vjeter (N2-Q1)

Depozitimet e kuaternarit te poshtem te mesem dhe te siperm te pandara (Q1-3)

Depozitimet e kuaternarit te sotem (Q4)

Depozitimet argjilore i perkasin kuaternarit te sotem (Q4) te cilat jane mjaft te studiuara. Keto depozitime kane perhapje te medha ku dallojme depozitimet aluviale ne rrjedhat e poshtme te lumenjve. Proluvionet takohen ne zonen kodrinore dhe ne luginat shpesh te nderthurura me aluvionet, deluvionet, koluvionet etj.

Ne zonat fushore kane perhapje dhe formime kenetore, liqenore-kinetore dhe sidomos ato aluviale-kenetore.

Ne zonen bregdetare takohen depozitimet detare dhe detare-kenetore. Depozitimet kenetore dhe liqenore-kenetore takohen ne Lezhe, Kakarriq, Velipoje etj. Ato kane nje trashesi nga disa metra deri ne dhjetra metra dhe perfaqesohen nga nderthurje shtresash argjilore ngjyre te erret me nuance nga kafe deri ne jeshile, suargjila, surera, rralla me perzierje dhe ndershtresa materiali me te trasha (zhur, zhavore). Takohen gjithashtu dhe ndershtresa te holla torfe.

Depozitimet liqenore kane perhapje te kufizuar dhe perfaqesohen nga shtresa argjilore, suargjilore e zhavore rerore me trashesi disa dhjetra metra.

Depozitimet detare perhapen ne bregdetin e vendit tone nga Shengjini deri ne Vlore.

Perfaqesohen nga rera dhe surera.

Karakteristikacilesore te vendburimit te argjilave "Gryka e Zeze" mbeshteten ne Raportin Gjeologjik. Per punimet gjeologjike te fazes se zbulimit te kryera ne vendburimin "Gryka e Zeze" dhe Balldre per lenden e pare per prodhimin e tullave e te tjegullave, e perpiluar nga Ndermarrja Gjeologjike Tirane, dhe te dhenave te grupit te Projektimit Teknologjik te ISTN, nxjerre nga Detyra e projektimit te Fabrikes se Tullave Lezhe, e miratuar nga Drejtoria e Industrise se Materialeve te Ndertimit si dhe ne pervojen disa vjecare te Fabrikes se Tullave, qysh ne venien e saj ne shfrytezim.

Raporti gjeologjik ne fjale eshte mbrojtur ne komisionin e rezervave prane Keshillit te Ministrave konform vendimit Nr.258 date 24.10.1975. Vendburimi i argjilave per tulla "Gryka e Zeze", nga ana administrative ben pjese ne rrethin e Lezhes. Vendburimi ndodhet ne verilindje te rrethit Lezhe ne periferitij, shtrihet ne bregun e djathte te perroit "Gryka e Zeze", fare prane tij nga merr edhe emrin vendburimi.

Pika me e afert e banuar eshte qyteti i Lezhes. Vendburimi paraqitet me nje relief fushore me kuote absolute 2-3.5 m duke zene nje siperfaqe prej 0.48 km². Zona e Lezhes ben pjese ne zonen me klime mesdhetare me dimer

te bute e vere te nxehte, me reshje minimale ne muajt Qershor, Korrik dhe Gusht dhe maksimale ne muajt Shkurt, Mars, Prill, Maj, Shtator dhe Dhjetor.

5.7 Kushtet hidrogeologjike dhe rrjeti hidrografik i rajonit.

Duke qene se vendburimi ndertohet teresisht nga depozitime argjilore te pa pershkueshem ndaj ujit edhe ujrat nentoksore jane te kufizuara.

Ujrat nentoksore shfaqen ne afersi te siperfaqes nga filtrimet e rreshjeve kryesisht nepermjet mikrotektonikave . Per nga ujembajtja e tyre depozitimet argjilore ne teresi karakterizohet nga nje filtrim i dobet i reshjeve atmosferike ato nepergjithsi jane te papershkueshme ose me pershkueshmeri te ulet, natyrisht

ne vartesi te shkalles se çarshmerise, te shtresezimit, karstezimit dhe nderlikimit tektonik te tyre.

Depozitimet e argjilave te vendburimit karakterizohen nga ujembajtje e paket.

Ne zonen e krkuar per shfrytezim nuk ka ujra nentoksore te depozituara, mungon mjedisi gjeologjik prandaj nuk do te behen shpime per uje te pijshem ose industrial.

Ujrat e rreshjeve atmosferike qe filtrojne ne carjet dalin ne kontaktin e flishit me argjilat ne nje numer minimal burimesh kryesisht ne pranvere dhe dimer periudhen e rreshjeve atmosferike, me te cilat furnizoheshin ne te kaluar me uje te pijshem banoret e zones, keto ujra kohet e sotme grumbullohen ne ujmbledhesit e ndertuar ne kete zone dhe perdoren per ujitjen e tokave te fermereve.

Nga sa thame me larte kushtet hidrogeologjike te vendburimit jane te favorshme, sepse gjate hapjes, pergatitjes dhe shfrytezimit te argjilave me kariere, nuk do te takohen ujra nentoksore

Konfigurimi shtresore ndikonne amplituden e vales sizmike. Kur ka ndryshime te mprehta te veçorive shkembore .

Vecorite topografike. Ato maja qe jane temprheta te hyjne ne interference me valet sizmike. Ne keto raste eshte e rendesishme te mos ndertojme ne maja por ne toka te buta.

Lengezimi dhe kompakesimi. Jane fenomene qe ndodhin ne goditjen e nje vale sizmike ne truallt e shkrifta dhe te ngopura me uje. Pas lengezimit do te ndodh kompakesimi i cili shoqerohet me çarje dhe ulje te truallit.

Per sa i perket kategorise se truallit ku vendosen te ndertohen objektet e ndertimit ndahen ne dy kategori: ne kategorine e pare hyjne **deluvionet**, leset dhe depozitimet akullnajore. Ne te dyten hyjne shkembinjte rrenjesore si: **gelqeror, ranor, apo argjilore te perfshire nga alterimi.**

Si perfundimmund te themi se ndarja kryesore eshte truall i kategorise se pare dhe truall i kategorise se dyte qe bejne pjese shkembinjte dytesore.

4.1.2 Pershkrimi gjeologjik i tokes ne vendin e zbatimit te projektit.

Ne ndertimin gjeologjik te vendburimit marrin pjese depozitimet kenetore te antroneogjenit. Keto informacioni ne vendburim duke filluar nga larte-poshte perfaqesohen nga suargjila me ngjyre bezhe, me njolla ngjyre gri me plasticitet mesatar, me prekje te buta te cilat me kalimin e koheskalojne ne argjile me ngjyre te kalter me plasticitet te mire, mjaft te buta ne prekje me pembajtje materiali humusor, qe i jep argjiles ngjyre te erret. Keto argjile duke kaluar poshte hipsometrikisht kalojne ne argjila ne gjendje llumi me lageshti te erret. Keto argjile ne gjendje llumi, vazhdojne me rera plotesisht te shkrifeta, kokerrimet, te perziera me material argjilor po me gjendje llumi me ngjyre te kalter te erret qe lidhet me prezencen e materialit humusor.

Mbi shtresen subargjilore eshte zhvilluar toka vegjetale (bujqesore) me trashesi mesatare 0.5 m e formuar si rezultat i perajrimit te subargjilave.

Kjo ka ngjyre te verdhe, perberjesubargjilore e prekje mjaft te shkrifet dhe e pasur me rrenjebimesh, dhe ka nje perberje granulometrike ne pergjithesi heterogjene.



Ne keto foto pamje ne distance e objektit dhe zones rrethuese..

4.1.3 Pershkrimi i ujrave sipërfaqesore dhe nentokesore te zones

- 4.2 Nga pikpamja hidrogeologjike, mund te theksojme qe nga punimet e kryera ne sheshin e ndertimit, nuk eshte takuar nivel i ujrave nentokesore, dhe per me teper depozitimet mbi te cilat vendoset sheshi jane te varfera me ujra nentokesore.
- 4.3 Ne baze te ndertimit litologjik te zones se studimit ku kemi mbizoterim te pakove argjilore mbi ato ranoro-knoglomeratike, mund te themi se zona e cila do te shfrytezohet eshte teresisht argjilore dhe si e tille nuk kemi rrezik te shperthimit te ujerave gjate shfrytezimit. Gjate procesit te shfrytezimit nuk do te preken zona ujembajetese dhe per kete arsye sipërfaqja e karrieres do te mbetet gjithmone e thate. Ujerat e shirave do te largohen per veterrjedhje te lire ose me pompa.

4.4 *Pershkrimi i biodiversitetit ne zonen ku zbatohet projekti.*

4.4.1 Pershkrimi i habitateve kryesore ne zonen e projektit dhe harta ilustruese.

Biodiversiteti ose larmia biologjike kupton shumllojshmerine e organizmave te gjalla e te gjitha llojeve duke perprshire te gjithe llojet e ekosistemeve. Evidentimi i ketij biodiversiteti dhe vlerave te tij si dhe kombinimi i tyre me nevojat dhe zhvillimin e popullsise lokale dhe perfshirja e tij ne planet e manaxhimit. Zhvillimi i infrastruktures ne keto zona ishte nje ndihme shume e mire per “transportimin e vlerave” midis tyre dhe atyreve qe lidhin biodiversitetin dhe zhvillimin e qendrushem ne pergjithsi. Nga ana tjeter projektimi i çdo nje te vepres duhet te marre parasysh dhe ndikimin ne biodiversitet. Zbatimi korrekt i rregullave te percaktuara dhe perfshirja e popullsise lokale ne manaxhim dhe zhvillimin e qendrushem te ketyre natyrore, do te ishte menyra me e mire per ruajtjen e habitateve me vlere. Prandaj para se te merren vendimet per nje zone duhet bere studim i detajuar dhe i specializuar mjedisore. Habitat kryesore ne zone jane **Uji, Ajri dhe Toka.**

4.4.2 Pershkrimi i vegjitacionit ne secilin habitat dhe statusi i ruajtjes kombetare dhe nderkomtar i tyre.

Ne uje jeton ndonje peshk uji lumi dhe alga, per te mbrojtje kete zone ku preken ujrart sipërfaqesore eshte caktuar qe 10% e volumit te ujit do te rrjedh ne rrjedhen e meparshme. **Ne tokeshqetesimi** eshte i faunes dhe i flores ne kohen e shfrytezimit, ndersa mbas shfrytezimit nuk ka shqetesim te gjallesave dhe bimesise.

Gjitaret ne zone. Zona vleresohet si e pasur ne biodiversitet kryesisht me kafshe te medha gjitare. Dallohen kafshet mishngrenese si : ujku, dhelpra, kunadhja, macja e eger etj. Nga kafshet barengrenese rritet lepuri, baldosa dhe me rralle dhia e eger.

Shpendet ne zone. Prezenca e burimeve ujore ne zone dhe vlerate e tjera natyrore si dhe presjoni human me vlere te uleta favorizon zhvillimin e shpendeve te egra ne zone si familja e harabeloreve eshte me e perhapura ne kete zone nga vrojtimet verehet prezenca e : *gardelines- Garduelis garduelis bilbili i perhimet -Silvia communis*, *bishtshkundes i bardhe Motacilla alba. Gushkuqi -Erithakus rubekula, bilbili -Luscinia megarhychos, ceku i zi -Saxiola torquata, mellenja -Turdus merula, trsishtili i madh -Parus Major, laraska -Pica pica, Sorra -Corvus corone, Harabeli i shtepise -Passer domestikus, harabeli i fushes- Passer montanus etj.*

4.4.3 Pershkrimi i zones se mbrojtur prane vendit ku propozohet projekti.

Ne kuadrin e pergjithshem te vleresimit dhe manaxhimit te burimeve natyrore si dhe mbrojtja e mjedisit, nje vend te rendesishem ze dhe perfshirja e sipërfaqeve te caktuara ne rrjetin e zonave te mbrojtura. Edhe ne vendin ku do te zbatohet projekti nuk ka zona te mbrojtura

4.5 *Pershkrimi i cilesise se mjedisit dhe ndikimet egzistuese.*

4.5.1 **Cilesia e ujrave ne zonen e studjuar.**

Ndotja e ujrave siperfaqesore dhe atyre te nendheshem eshte pasoje e thuajse te gjitha veprimtarive aktuale urbane, industriale dhe bujqesore. Ndotja historike po kontribuon gjithashtu ne cilesine e ulet te shume ujrave siperfaqesore. Ujrat e zeza urbane paraqesin problem te veçante si pasoje e grumbullimit jo te plote dhe aspak efikas dhe mungeses se trajtimit te tyre. Rrjetet ekzistuese nuk jane mirembajtur dhe as nuk jane zgjeruar per te perballuar urbanizimin e shpejteqe ka ndodhur keto dhjete vitet e fundit, nje pjese e madhe e te cilit eshte i shperndare, duke e berekeshu infrastrukturen te veshtire e te kushtueshme per ta siguruar. Pjesa me e madhe e fshatrave, kombinojne sistemet e kanalizimit te ujrave te zeza dhe mbledhjes se ujit te shirave te rrembyeshem qe shkarkohen direkt ne ujin siperfaqesor. Kanalet e ujerave te zeza shpesh jane me te vegjel se permasat normale, te çare ose te bllokuar si pasoje e mirembajtjes se dobet. Rrjedhjet nga keto kanale bartin rrezikun e ndotjes se rrjetit te ujit te pijshem dhe atogjithashtu ndotin token dhe ujrat freatike. Ndermarrjet tregtare dhe industriale qe prodhojne llojete tjera mbetjesh kimike . Percaktimi i gjendjes se krijuar te mjedisit ujqor eshte çeshtje komplekse dhe ndoshta perfshin edhe mija kimikate te ndryshme. Vleresimi i efekteve te ndotjes eshte po aq kompleks per shkak tegames se gjere te kushteve ekologjike te lumenjve dhe liqeneve. Kushtet e pergjithshme te ujravesiperfaqesore, mund te vleresohen nga niveli i **konduktivitetit** (treguesi i kripezimit), **oksigenimi**(treguesi i ndotjes organike) **dhe turbullira**(tregues te trupave te ngurte ne pezulli nga erozionidhe burime te tjera). Nivelet ideale te perqendrimt te oksigenit te tretur ne uje per shume peshq jane ndermjet 7 dhe 9mg/l edhe pse 9-12 mg/l nevojitet per troften e rritur ngjyre kafe. Shume pak peshq mund tembijetojne ne perqendrime poshte 3 mg/l te oksigenit te tretur ne uje. Standardi prej 8 mg/l perfaqeson standardin mesatar qe zbatohet ne legjislacionin e Komunitetit European ne siperfaqet ujore me peshq te zonave te ulet. Momentalisht nivelet e regjistruara ne disa lumenj te Shqiperise jane poshte ketyre niveleve. Keto perbejne vlere mesatare dhe kushtet variojne pergjate gjatesise se lumit. Situata ne drejtim te rrymes, ne te gjitha zonat urbane eshte gjithmone e me e keqe, pasi derdhja e ujrave te zeza ndikon ne nivelin e oksigenit. Niveli i turbullires se lumit eshte pergjithesisht i larte. Edhe pse turbullimi krijohet vetvetiu ajo shtohet ne menyre artificiale nga ndotja ne zonat urbane dhe erozioni i tokes. Nivele te larta te substancave ushqyese ne uje, sidomos azot dhe fosfor nga ujrat e zeza ose mbetjetbujqesore, mund te behen shkas per rritje te shpejte te bimeve, algave dhe bakterieve. Ky eutrofikim sjell shterimin e oksigenit ne uje dhe çlirimin e toksinave. Perzierjet toksike organike dhe metalet qe nxirren nga germimi dhe aktiviteti industrial paraqesin probleme te tjera.

4.5.2 **Cilesia e ajrit ne zonen e studjuar.**

Indikatorët më kryesorë të cilësisë së ajrit, **LNP, PM10, NO₂, SO₂, Pb, O₃, CO dhe BTEX** të përzgjedhura qellimisht në zonat urbane më të rënduara, përfaqësojnë treguesit më të rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së tij, mbështetur në udhëzimet e BE-së dhe të reflektuara edhe në VKM nr. 803, datë 4.12.2003 “Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit “. Monitorimi i ajrit është realizuar me pajisje automatike, për indikatorët e gaztë NO₂, O₃ të dhënat regjistrohen çdo 30 minuta kurse të dhënat e SO₂ regjistrohen çdo 5 minuta, d.m.th matjet realizohen 100% të kohes vjetore. Monitorimi i pluhurave (PM10) realizohet 24 orëshe.

Përmbajtja e ndotësive të gaztë (NO₂, SO₂).

Në vlerësimin e cilësisë së ajrit urban, rëndësi të veçantë ka përmbajtja e gazeve, nivelet e larta të së cilave janë me pasoja të rëndësishme për shëndetin dhe për mjedisin.. Sipas të dhënave, ajri urban rezulton i pastër nga ndotësit e gaztë, pasi në të gjithë stacionet përmbajtja e SO₂ dhe NO₂ janë brenda normave të lejuara të Standardit Shqiptar .

Situata për ndotjen nga LNP dhe PM10.

Ndotja nga lënda e ngurtë në gjëndje pezull, përbën një nga problemet kryesore për cilësinë e ajrit urban në vendin tonë. Pluhurat janë një nga ndotësit e ajrit që realisht shkaktojnë probleme serioze në shëndetin e njeriut.

Ndotja nga PM10 sipas rekomandimeve të OBSH është rreziku më i madh shëndetësor sot për ajrin urban në shkallë botërore, pasi grimcat me përmasa nën 10 mikron mund të depërtojnë në pjesën e poshtme të mushkerive.

Kjo ndotje vjen kryesisht nga shkarkimet e automjeteve dhe është karakteristike për makinat e vjetra me motor dizel. Gjithashtu ndërtimi dhe infrastruktura në ndërtim janë kontribues në rritjen e PM10 dhe LNP.

Ndotësit Fotokimik.

Në shumë mjedise urbane ndotësit fotokimike janë bërë burime kryesore të ndotjes së ajrit. Ata shkaktohen kryesisht nga përdorimit në rritje të automjeteve dhe shkarkimeve të tyre, si rezultat i reaksioneve kimike midis ndotësive primare dhe përbërësve të tjerë të atmosferës.

Zakonisht, për tu zhvilluar këto reaksione kanë të domosdoshme dritën e diellit, dhe si rezultat ato krijojnë smogun fotokimik, i cili është më i përhapur në zonat që kanë rrezatim diellor të konsiderueshëm. Hidrokarburet që vijnë nga shkarkimet e automjeteve dhe burime të tjera luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e ozonit në mjedisin urban.

Jo i gjithë ozoni i shtresës së ulët të atmosferës vjen prej aktiviteteve njerëzore, por ai vjen dhe nga burime natyrore dhe nga difuzioni i një pjese të ozonit nga pjesa e sipërme e atmosferës.

Kushtet e favorshme për krijimin e ozonit janë temperaturat e larta të ajrit mbi 32°C, rrezatim diellor intensiv dhe mungesa e reshjeve të shiut.

Në përgjithësi niveli i përmbajtjes së plumbit në të gjitha stacionet e monitoruara është shumë i ulët në krahasim me normat e lejuara të standartit tonë po kështu dhe me Standartin e BE.

Rritja e numrit të automjeteve, si burimi kryesor i shkarkimeve të plumbit, ende nuk ndikon dukshëm në rritjen e përmbajtjes së plumbit në ajrin urban në stacionet e monitoruara, kjo për arsye ndoshta të numrit të vogël të makinave që përdorin benzinën si lëndë djegëse.

Niveli i përmbajtjes së CO në stacionet e monitoruara është tepër i ulët në krahasim me normat e lejuara të standartit tonë.

Po kështu mund të themi dhe për benzenin, monitoruar në tre stacione, vlerat vjetore janë më e ulët se vlera vjetore e standartit Shqiptar.

Kjo ndoshta për arsye të numrit të vogël të makinave që përdorin si lëndë djegëse benzinën, nuk ndikon dukshëm në rritjen e përmbajtjes së benzenit në ajrin urban në stacionet e monitoruara .

Skenari i emetimeve totale të gazeve me efekt serë (GS)

Politika e ndryshimeve klimatike është ndërtuar përmes komunikimit kombëtar duke paraqitur veçmas zbutjen e gazeve serë dhe përshtatjen. Për secilin prej tyre dhe çdo sektor është kryer analiza dhe zhvillimi i skenarëve dhe janë propozuar masat për zbutjen dhe përshtatjen me ndryshimet e pritshme klimatike. Për të gjithë sektorët e analizuar janë ndërtuar dy skenarë: **Skenari bazë dhe skenari i zbutjes** të gazeve. Skenari bazë merr në konsideratë zhvillimin e sektorëve, pa marrë parasysh efektin e ndryshimit të klimës. Skenari i zbutjes merr në konsideratë zbatimin e një sërë masash prioritare, që ka për qëllim të arrijnë deri në vitin 2040, reduktimin e shkarkimeve të gazeve serë me 48%, në krahasim me skenarin bazë .

Forcat shtytëse dhe presionet.

Popullsia. Popullsia e kesaj zone i perket nje zone rurale dhe merret kryesisht me pune bujqesore dhe blegtorale. Ata banojne ne fshatrat per rreth me rreth 1000 banore, qe bejne pjese ne njesine vendore Kolsh,

pergjithesisht autoktone ku pjesa me e madhe e popullsisë janë larguar dhe po largohen prandaj hapja e ketyre vendeve të punës do të ndikonte sa do pak në uljen e kesaj plage.

Objekti i kerkuar ndodhet pranë rruges automobilistike që lidh fshatrat e zones.

Ushtrimi i aktivitetit mineral në vitet e fundit ka beret e mundur ndertimin e nje rrjeti shume te dendur rrugeshe që lidhin objektet e shfrytëzimit me rrugen që shkon në fshatin Kolsh. Rruga kryesore dhe ato dytesore në zone janë kryesisht në gjendje të mire të pa shtruara dhe shfrytëzimi i ketij objekti do të ndikojë dukshëm në permiresimin e infrastruktures se zones

- **Energjia.** Sektori i transportit dhe familjet janë konsumatorët kryesorë të energjisë për konsum. i **tektonikave kryesore.**

Tektonika e Objektivit.

Siç është trajtuar në pjesën gjeologjike të ketij projekti dhe studimet e kryera në kete rajon, argjilat e pakos produktive kanë nje trashësi prej 8-10ml. Objekti nuk ka carshmeri të zhvilluar. Çarjet në pergjithesi kanë nje hapje nga disa m/m në 7-10 cm. Fenomeni i Karstit është shume pak i zhvilluar. Shkëmbinjtë janë me qendrueshmeri mbi-mesatare. Kuota me e ulet në vendburim është -7.5 m dhe me e larta +2.5 m. Në pergjithesi argjilat janë kompakte me pak çarje.

Transporti urban dhe ai privat një nga faktorët kryesorë që ndikon në cilësinë e ajrit urban. Përdorimi gjithnjë e më shumë i transportit rrugor privat është shoqëruar me një numër të madh të vogël mjeteve transport. Transporti mbetet një nga burimet kryesore të ndotjes së ajrit urban, për shkak të:

Moshës mesatare relativisht e madhe e mjeteve të transportit (mbi 10 vjet) në krahasim me mesataren e vendeve të BE (që është 7.1), pasi automjetet e vjetra shkarkojnë disa herë më shumë NOx, monoksid karboni CO, gaze sulfurore SO₂, hidrokarbure në krahasim me makinat e reja me konverter.

Përdorimi i automjeteve të mëdha dhe më pak efikas.

Mirëmbajtja jo e mirë e automjeteve – ndonëse janë futur sistemet e testimit të automjeteve duhet theksuar se kontrolli i shkarkimeve të automjeteve nuk zbatohet siç duhet.

Menaxhim jo efikas i trafikut që shpie në dyndje dhe në kohë qëndrimi të gjatë. Kushte të këqija të rrugëve që shpie në amortizimin e shpejtë të automjeteve.

Industria.

Niveli i aktivitetit industrial është shumë më i ulët se në dekadat e mëparshme. Megjithatë, ndikimi i aktivitetit që kanë mbetur dhe i të rejave që janë krijuar është i lartë në krahasim me rendimentin e prodhimit. Shkarkimet e dyoksidit të karbonit (CO₂) për banorë janë shumë më të ulëta se në shumicën e vendeve të industrializuara, por shkarkimet e (CO₂) për njësi të PBB janë shumë më të larta sesa ato të vendeve të industrializuara.

Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit

Në sektorin e ajrit janë identifikuar katër qëllime kryesore. Dy prej tyre kanë lidhje me pakësimin afatshkurtër të ndotjes së mjedisit. Ndërsa qëllimet e mëtejshme janë kritike për vazhdimin e mbrojtjes së ajrit, dmth grumbullimi i të dhënave mbi cilësinë e ajrit të mjedisit dhe një sistem i planifikimit dhe kontrollit që do të sigurojë arrijtjen e objektivave të cilësisë së ajrit në një periudhë afatgjatë.

Objektivat kryesorë janë:

Pakësimi me 50% i numrit të rasteve të mospërputhjes me objektivat e cilësisë së ajrit.

Pakësimi i shkëlqeve të standardeve të cilësisë së ajrit.

Zbatimi i një sistemi kombëtar të monitorimit të cilësisë së ajrit në përputhje me kërkesat e Komunitetit Evropian.

Krijimi i një sistemi planifikimi të menaxhimit të cilësisë së ajrit në rang kombëtar dhe vendor.

Masa.

- Përafrimi i standarteve të karburanteve për automjetet me ato të standarteve Evropiane.
- Përmirësimi i kuadrit ligjor lidhur me importimin e automjeteve në drejtimin të vitit të prodhimit dhe cilësisë së motorëve.
- Menaxhimi i trafikut të automjeteve përmirësimi i infrastruktures së rrugëve në drejtim të trafikut.
- Strukturimi i qarkullimit urban si mjet për parandalimin e qarkullimit të automjeteve private.
- Reduktimi i zonave të ndertimit dhe shtimi i hapësirave të gjelbërta.

Rekomandime.

Meqenëse ndotësi kryesor i PM_{10} është shkarkimi i automjeteve rekomandohet:

- Kontrolli i cilësisë së lëndës djegëse që përdorin automjetet.
- Përmirësimi i infrastrukturës së rrugëve lidhur me transportin urban dhe atë privat (trafiku).
- Kontrolli i shkarkimeve të automjeteve me qëllim mos lejimin e makinave që nuk janë të mirëmbajtura.
- Monitorimi i cilësisë së ajrit në përputhje me kërkesat e BE.
- Instalimi i impianteve fikse të monitorimit të shkarkimeve të burimeve të lejuara në përputhje me kërkesat e BE.
- Krijimi i një rrjeti të plotë të monitorimit urban në përputhje me kërkesat e BE.

4.5.3 Niveli i zhurmave në zonen e studjuar.

Per sa i përket nivelit të zhurmave në objektin e ndërtuar tani për tani janë të nivelit pothuajse zero. Parametrat e zhurmave janë standarte të prodhimit të makinerive. Në kohën e ndërtimit zhurmat do të bëjnë presion mbi mjedisin, por ky presion ka qenë brenda standartit të teknologjive të ndërtimit të vepres.

4.5.4 Administrimi i mbetjeve.

Problemet e gjenerimit të mbetjeve dhe administrimit të tyre janë të shumta dhe të larmishme. Sasitë me të mëdha të mbetjeve të gjeneruara (nga punët) prirjen të jenë substanca inerte, sidomos mbetje nga ndërtimet. Ky sektor paraqet disa prej sfidave më të rëndësishme me të cilat duhet të përballëtohet Shqipëria.

- Sistemet për grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve janë të pamjaftueshme dhe aspak efektive;
- Nuk mund të merren vendime të sakta për alternativat e grumbullimit dhe hedhjes, në mungesë të një informacioni të besueshëm;
- Mungon ndërgjegjësimi publik për demin e shkaktuar nga keqadministrimi i mbetjeve.

Mbetjet urbane hidhen kryesisht në vende të caktuara për këto qëllime, por sasi të konsiderueshme hidhen edhe në vende të paautorizuara në lumë dhe përgjatë rrugëve. Në shumicën e rasteve, vendet e caktuara nuk janë projektuar për këto qëllime apo nuk administrohen mirë. Janë krijuar pa infrastrukturën e nevojshme apo masat teknike për grumbullimin e tyre dhe çlirojnë gaze të prodhuara prej mbetjeve të gropës dhe leng që formohet në fund të gropave të tyre. Shumë prej këtyre vendeve të grumbullimit nuk janë të siguruara dhe nuk janë mjetet e mjaftueshme për administrimin e tyre të qëndrueshëm. Si pasojë, hyrja në to dhe hedhja e paautorizuara është e zakonshme, ashtu si edhe zjarret. Inspektimi i mbetjeve hyrëse nuk praktikohet. Nuk mbahet proces verbal për depozitimet e bera. Investimet në këtë sektor deri tani ka qenë shumë të kufizuara. Megjithatë, po merren masa për modernizimin e një prej vendeve kryesore të grumbullimit të mbetjeve. Materialet shpesh i merr uji apo era dhe i shpërndan në mjedis, duke ndotur tokën dhe rrjedhën e ujit në bien. Afërsisht i njëjti vëllim i mbetjeve nga ndërtimet krijohet si mbetje urbane. Shumë prej tyre janë inerte, por përmbajnë gjithashtu metale, azbest, ose bojra dhe sasi të vogla materiale të tjera të inerta. Vëllimi do të rritet me rritjen e industrisë së ndërtimit. Një pjesë e madhe e tyre hidhet në vendet e grumbullimit të mbetjeve urbane. Megjithatë, në shumë zona, mbetjet e ndërtimit hidhen në vende të paautorizuara.

Mbetjet industriale.

Grumbullimi dhe heqja e mbetjeve industriale është përgjegjësi e prodhuesit. Nuk është mbledhur.

4.5.5 Problemet e tjera: si erozioni i tokes,zjarret,etj.

Gjendja e tokave eshte e rëndësishme per **bujqesine, pylltarine dhe biodiversitetin**. Nga ana e tyreketaja jane te rëndësishme per **ekonomine, shendetin publik dhe turizmin**. Dy jane problemet kryesore dhe me shqetesuese: **Erozioni dhe prishja e cilesise se tokes**.

Erozioni.

Erozioni eshte procesi natyror i veprimit te ujit dhe eres mbi token. Megjithate, shkalla e erozionit mund te rritet shume nga aktivitetet e papershtashme te njerzve. Nivelet e larta te erozionit paraqesin nje sere problemesh dhe te gjitha jane te pranishme sot ne Shqiperi, perkatesisht:

- Prishja e cilesise se tokes dhe humbja e pjellorise;
- Eshte shtuar rreziku i rreshqitjeve te tokes dhe humbjes se saj;
- Depozitimi i sedimentit ne lumenj, qe ndryshon rrjedhen e tyre natyrore dhe ekologjine;
- Akumulimi i trupave te ngurte prapa digave, duke ulur sasine e ujit ne liqene dhe rrethohet kapacitetin prodhues te impianteve te prodhimit te energjise elektrike.
- Shpyllezimi, kthimi i siperfaqeve me kodra ne toka te punueshme, mbikullotja, zhdukja e siperfaqeve me drure frutore dhe ndertimet, sidomos i rrugëve, te gjitha keto zvogelojne siperfaqet me bimesi dhe si pasoje rrisin erozionin.
- Humbja e tokes ne nje vit varion nga nje minimum 20 ton/hektare ne zonat malore me borene periudhen e dimrit dhe nje maksimum 40 ton/hektare ne zonat me te ulta me shira nedimer, ne rastet ekstreme, kjo humbje arrin ne nivelet e 100 ton/ha/vit.
- Humbjet llogariten te jene 1.2 deri 2.3 here me te larta ne zonat pa bimesi ne krahasim mezonat me te mbjella. Nje pjese e madhe e sedimentit te gerryer perfundon ne lumenj. Funkcionet natyrore te fushave qepermbyten ne shperndarjen e ketij sedimenti kane ndryshuar, pasi lumenjve u eshte hapur shtratiper mbrojtje ndaj permbytjeve dhe per qellime bonifikimi te tokes dhe shumica e sedimentit tanitransportohehet ne det, gje qe rrit nivelin e turbullires dhe demton faunen dhe floren e vlefshme.
- Praktika e nxjerrjes se zhavorrit nga shtrati i lumenjeve kontribuon gjithashtu ne problem erozioni, duke ndryshuar karakteristikat e kanaleve te lumit dhe ngarkesen e sedimenteve.
- Mbi bazen e te dhenave te disponueshme, eshte llogaritur qe afersisht 16 milion ton ose 4m³ per person ne vit te materialeve te ngurta derdhet ne det. Keto te dhena tregojne, edhe hedhja e pakontrolluar e mbetjeve ne fshat, te cilat me se shumti sherbejnesi ushqim per bagetine ose ndosin token.

Cilësia e tokës.

Ne terma te pergjithshme, tokat bujqesore duket se jane ne gjendje te pranueshme. Megjithate, kazona qe u jane nenshtuar ndotjes ekstreme si pasoje e aktiviteteve industriale, me pasoja pershendetin, ku substancat ndotese arrijne te futen ne zinxhirin e ushqimit. Rrezikparaqet gjithashtu, edhe hedhja e pakontrolluar e mbetjeve ne fshat, te cilat me se shumti sherbejnesi ushqim per bagetine ose ndosin token.

Hapat në vijim: administrimi i tokës.

Kontrolli i erozionit eshte kerkesa kryesore, e shoqeruar nga praktikatat e administrimit te baseneve te lumenjeve dhe te cilat ulin efektet negative te transportimit dhe depozitimit te sedimenteve.

Masat qe kerkohet te merren per te permbushur keto kerkesa perfshijne:

- Ndryshimin e legjislacionit dhe forcimin e institucioneve per te mundesuar zbatimin e ligjit;
